



REPUBLICA E KOSOVËS - VLADA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIE - MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE - MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY	
Njësia Org. Org.Jedinita Org.Unit	01
Nr.Proj. Broj,Prot. Prot.No.	7046
Data Datum. Date.	19/10/17

Republika e Kosovës
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry
Kabineti i Ministrit - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister

01 Ref. Nr.05
Prishtinë, 19.10.2017

Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, nenit 43 të Ligjit Nr. 04/L-240 për Masat Antidamping dhe Masat Kundërbalancuese, si dhe nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 8 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive merr:

V E N D I M

1. Vendoset masa përfundimtare lidhur me importin e miellit që importohet nga Republika e Serbisë në Republikën e Kosovës me tarifa prej 0.04 cent.
2. Bazuar në Memo-në shpjeguese të Departamentit të Tregtisë dhe Komisionit për vlerësimin e masave në import të datës 19.10.2017, Dogana e Republikës së Kosovës udhëzohet që të ndërmarrë të gjitha masat për mbrojtjen e prodhuesve të miellit për të aplikuar tarifën në masën prej 0.04 cent.
3. Ministria do të përcjell në vazhdimësi efektin e këtyre masave dhe në varësi të lëvizjeve në treg do të veprojë sipas nevojës.
4. Vendimit i bashkëngjitet Memo shpjeguese e përpiluar nga Komisioni dhe Departamenti i Tregtisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi me datën 23 tetor 2017.



Bajram HASANI
Ministër i MTI-së

Vendimi i dërgohet:

- Doganës së Kosovës;
- Zyrës së Kryeministrit/ ZKM;
- Ministrisë së Financave;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm/MTI;
- Anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta të Importit;
- Departamentit të Tregtisë;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MTI-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË/ MINISTARSTVO TRGOVINE INDUSTRIJE/
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY
DEPARTAMENTI I TREGTISË

Prishtinë, 19 Tetor 2017

Memo shpjeguese lidhur me rekomandimin për vendosjen e masës përfundimtare lidhur me importin e miellit që importohet nga Republika e Serbisë në Republikën e Kosovës

Në Departamentin e Tregtisë në kuadër të MTI-së me datën 07 Prill 2017 është adresuar kërkesa nga kompania për prodhimin e miellit "M&Silloi", kërkesë e cila është iniciuar poashtu edhe nga Shoqata e Mullisëve të Kosovës me datën 2 qershor 2017, e cila kërkon të mbrohet prodhimi vendor konkretisht mielli, me dyshimin se importohet nga Serbia në Kosovë me çmime më të ulëta se vlera reale e çmimit të tregut respektivisht nën koston e prodhimit, ku po e rrezikon industrinë prodhuese të miellit në Kosovë në përgjithësi.

Ekipi i Departamentit të Tregtisë në bashkëpunim me Komisionin për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe, ka përfunduar një hulumtim të detajuar në lidhje me shkresën në fjalë, me qëllim të identifikimit të gjendjes reale të importit të miellit nga Serbia dhe për të konstatuar se a ka dumping në këtë produkt. Për këtë qëllim, ekipi hulumtues bazuar në Ligjin mbi masat anti-dumping dhe masat kundër- balancuese ka shfrytëzuar dy metoda për identifikimin e problemit:

1. Metodën e kostove të prodhimit dhe
2. Metodën e vlerës reale të çmimit të tregut

Kalkulimi i kostos së përpunimit nga gruri vendor (normativi)

Në vijim po paraqesim kalkulimin e kostove të përpunimit të grurit vendor (normativin) për prodhimin e miellit T-500/T-400 dhe krundeve, bazuar në të dhënat e siguruara nga kompania "M&Silloi" dhe normativit të Shoqatës së Mullisëve të Kosovës. Të dhënat argumentohen me faturë përkatëse për secilin pozicion të normativit.

Për Ton/Sh.	Ton	€	Totali/€
Gruri	1	160,00	160,00
Tr. i grurit	1	6,00	6,00
Rryma	1	8,50	8,50
Amb-Thas-Mielli	1	5,00	5,00
Amb. Thas-	1	2,50	2,50
Pasurii Mi.	1	1,50	1,50
Pagat e P	1	9,00	9,00
Shp. Adm.	1	8,00	8,00
Amortizimi	1	13,00	13,00
Shpe. tjera	1	3,50	3,50

Totali i shpenzimeve për TON: 217,00

Të hyrat për ton	Ton	€	Totali/€
Miell T-500	70%	190€/T	133,00
Krunde	30%	90 €/T	27,00

Totali të hyra nga shitja: 160,00

Kostoja e prodhimit për Ton: 217,00

Fitimi nga shitja për një Ton: 160,00

Ndryshimi: Kostoja –Fitimi = 57,00 tregon humbje

Përveç kësaj, nga vizitat dhe të dhënat e siguruar edhe nga 2 kompani tjera vendore, dele e njëjta situatë ku kompanitë punojnë me humbje (kompania “Universal Food”; “Dani Company”; “Burimi”; Rizam Holding”; “Amidoni”; “Barileva”).

Nga kalkulimet e bëra lidhur me koston e prodhimit të një toni miell T-500, konstatohet në të gjitha kalkulimet nga kompanitë si dhe normativi i Shoqatës së Mullisëve të Kosovës, tregojnë se kanë humbje (kompania “M&Silloi” **57,00€**, kompania “Univerzal Food” **55,50 €**, Kompania “Dani Company” **53,00 €**, dhe Shoqata e Mullisëve të Kosovës **54,70 €**; Kompania “**Burimi**”**54.00 €**;kompania “Rizam Holding” **53.50€**; kompania “Amidoni” **48.00€**; kompania “Barileva”**52.00 €**).

Mesatarja e humbjeve (raporti në mes të çmimit shitës të produkteve finale dhe koston së prodhimit) për këto kompani (mullinjë) është **53.46€**

(57.00+55.50+53.00+54.70+54.00+53.50+48.00+52.00=427.70/8=53.46)

Hulumtimi i kryer në lidhje me çmimet e deklaruar me rastin e importit të miellit në Kosovë nga Serbia, tregon se çmimi mesatar i deklaruar është 0.19 cent për kg (bazuar në koston reale të prodhimit të miellit dëshmohet se çmimi eksportues i miellit nga Serbia, është më i

ulët se sa kostoja e prodhimit në Kosovë për rreth 31.80%). Nga informata që kemi në tregun e Serbisë një pako 25kg e miellit shitet me 8.60 € (kalkulimi: $8.60:25=0.344\text{€}$ për kg).

Përkundër vështirësive në sigurimin e informacioneve në lidhje me koston e prodhimit të miellit në Serbi, duke marrë parasysh informacionet në dispozicion në lidhje me industrinë e miellit dhe kostot prodhuese, vlerësohet se është e pamundshme që me çmimet e tregut të lëndës së parë bazike (grurit) në Serbi, çmimi i produktit final të miellit, të jetë ai që deklarohet me rastin e eksporteve në Kosovë. Poashtu, duke pasur parasysh se të gjitha kalkulimet e kostove të prodhimit tregojnë se kompanitë vendore prodhuese punojnë me humbje, mund të konstatohet se kemi të bëjmë me çmime të nënvlerësuara të importit të miellit nga Serbia dhe në këtë drejtim Serbia është duke eksportuar në Kosovë miell T-500 me çmime të dampuara.

Po ashtu, Departamenti i Tregtisë së bashku me Komisionin për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe kanë zhvilluar një vizitë hulumtuese 1 ditore në Shqipëri për të siguruar çmimet e miellit pasi që shteti serb nuk ka ofruar bashkëpunim që nga fillimi në hulumtimin e rastit. Prandaj, në bazë të nenit 37 paragrafi 2 i Ligjit për Masa Anti-dumping dhe Masa Kundër-balancuese përcakton *“Me qëllim të verifikimit të informacioneve të mbledhura dhe për të marrë informacione shtesë, Ministria, nëse e gjykon të nevojshme, mund të kryejë hetime edhe në vende të tjera, me kusht që ndërmarrjet në fjalë të japin pëlqimin e tyre dhe Qeveritë e vendeve në fjalë të jenë të njoftuara zyrtarisht dhe të mos ngrenë asnjë kundërshtim. Autoritetet e vendit eksportues duhet të njoftohet për emrat dhe adresat e ndërmarrjeve që do të vizitohen dhe datat e vizitave”*, Departamenti i Tregtisë në bashkëpunim me Komisionin kanë vizituar 3 kompani në “LekBibaj” Reshen, “Diamond” Tiranë, (çmimi i grurit 185€ kurse kostoja e një toni miell është 230€ që do të thotë $230-185=45\text{€}$) dhe “Alb Mines Investment” Vore (Çmimi për 1 ton grurë 184, kurse kostoja e prodhimit për 1 ton miell është 220.87 €, që do të thotë $220.87-184=36.87\text{€}$). Nga këto kompani është siguruar kostoja e prodhimit për miellin.

Ndërsa, konstatimi nga vizita hulumtuese e zhvilluar në Shqipëri është si vijon: ekipi hulumtues është njoftuar për së afërmi me koston e prodhimit të miellit dhe është vërtetuar se çmimet e kostos së prodhimit janë të përafërta me koston e prodhimit të produkteve të cilat prodhohen në Kosovë.

Vlen të theksohet se me dt. 22 Shtator 2017 Departamenti i Tregtisë ka përcjellë te Ministria e Tregtisë e Serbisë, njoftimin për fillimin e hetimeve zyrtare dhe pyetësonin me qëllim

marrjen e informatave, mirëpo pala serbe nuk ka shprehë gatishmëri për bashkëpunim për arsytet që tashmë dihen.

Në vitin 2016 sipas të dhënave nga MBPZHR janë mbjellë me grurë 80.806,3 ha me një prodhimtari prej 358.017 ton, ku rendimenti mesatar për një hektar ka qenë 4.4t/ha. Krahasuar me vitin 2015 kemi një sipërfaqe më të vogël për 1.247,7 ha.

Megjithatë, duke u bazuar në rendimentet e prodhimit të grurit prezantuar nga të dhënat statistikore, shihet se kemi rritje të sasisë së prodhimit të grurit në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 (358.017 t/ha në vitin 2016 - 284.435 t/ha në vitin 2015 = 73.582 t/ha) 73.58 ton grurë më shumë, dhe kjo për shkak të rritjes së rendimentit nga 3.4 sa ishte në vitin 2015, në 4.4 në vitin 2016. Te dhënat për sasinë e grurit për vitin 2017 janë: Sipërfaqja 70.200 ha x rendimenti 3.7 ton = 259.740 ton prodhimit vjetor. Nevojat vjetore për grurë janë 360.000 ton, ndërsa konsumi për kokë banori 200 kg grurë, gjë që e dëshmon që ka rënie të sipërfaqes së mbjellë me grurë, (358.017 t/ha në vitin 2016 - 259.740 t/ha në vitin 2017 = 98.277 t/ha).

Sipërfaqet, rendimentet dhe prodhimitaria e grurit për vitin 2015-2017

Burimi: Drejtoritë Komunale për Bujqësi

Lloji i kultu.	2015			2016			2017		
	Sipërfaq/ha	Rendimet/ha	Prodhim/t	Sipërfaq/ha	Rendim./ha	Prodhim/t	Sipërfaq/ha	Rendim./ha	Prodhim/t
Gruri	82054	3.4	284,435	80806.3	4.4	358,017	70.200	3.7	259.740

Analiza e importit dhe eksportit të grurit dhe miellit në Kosovë për vitet 2014-2017

IM4+IM7 Importi i grurit dhe miellit për periudhën: 01/01/2014 deri 17/10/2017

	Mielli		Gruri	
	Neto kg	Vlera/Çmimi	Neto kg	Vlera/Çmimi
2014	54,474,424.93	13,230,957.89	51,837,836.28	11,456,289.76
2015	55,704,590.58	14,128,623.34	61,666,513.00	12,727,647.83
2016	42,534,528.36	9,602,657.33	148,379,018.00	24,319,895.67
2017	15,110,682.84	3,340,339.27	28,773,960.00	4,773,910.99

Burimi: Dogana e Kosovës

EX1-Eksporti i rregullt dhe EX3-Re eksporti**Prej: 01/01/2014 deri 17/10/2017**

	Mielli				Gruri			
	EX1		EX3		EX1		EX3	
	Neto kg	Çmimi	Neto kg	Çmimi	Neto kg	Çmimi	Neto kg	Çmimi
2014	966,220	247,392	25,224,222	6,252,289	221,575	50,944	-	-
2015	1,179,000	269,785	16,581,084	3,895,526	772,000	197,990	-	-
2016	20,825,209	4,122,517	91,461	17,326	325,000	80,400	-	-
2017	16,658,596.42	3,369,124.92	-	-	228,000.	64,390	25,000	4,150

Burimi: Dogana e Kosovës

Çmimet e miellit T-500 në tregun e Kosovës dhe Shqipërisë

Departamenti i Tregtisë në bashkëpunim me Komisionin, ka hulumtuar edhe tregun me pakicë të shitjes së miellit në Kosovë si dhe në Shqipëri. Në Shqipëri u zhvillua vizitë medt. 17 Tetor 2017 në këto kompani të prodhimit të miellit:

- “LekBibaj” Reshen
- “Diamond” Mamuras dhe
- “Alb Mines Investment“ Vore

Më poshtë janë të dhënat individuale për secilin treg të hulumtuar.

Çmimi i miellit T-500 në Kosovë

Çmimet e miellit të siguruara në qendrën tregtare “INTEREX” gjatë vizitës së ekipit:

T-500 me çmim prej 6.89 € ndërsa T- 400 me çmim prej 9.99 €;

Çmimi i miellit T-500 në Shqipëri

T-500 me çmim prej 1200 lek (9.16€).

Nga analiza e lartë cekur, tabela në vijim pasqyron krahasimin e çmimeve të miellit T-500:

	T-500/Çmimi
Kosovë	6.89 €

Shqipëri	1200lek/ 9.16 €
----------	-----------------

Bazuar në hetimin preliminar, analizave dhe dëshmive të grumbulluara kishte dyshime të bazuara se kemi të bëjmë me çmime dumping, prandaj Departamenti i Tregtisë në bashkëpunim me Komisionin për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe, i kanë rekomanduar Ministrit të MTI-së që të bëhet hapja formale e hetimeve dhe shpallja në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Vendimi nga Ministri është nënshkruar me dt. 21 Shtator 2017 dhe po të njëjtën datë është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe ka mbajtur takim me dt. 18 Tetor 2017ku anëtarët e komisionit kanë propozuar vendosjen e një mase të përfundimtare në vlerë prej 0.04 cent për kilogram.

Pas analizës së lartë-cekur dhe dëshmive të grumbulluara, Departamenti i Tregtisë në bashkëpunim me Komisionin për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe, i rekomandojnë Ministrit të MTI-së vendosjen e masës përfundimtare prej 0.04 cent për kilogram.